# DËSHMI ARKIVI

**A-448549**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Gjyqi ndaj UÇK/ Gjykata Speciale: Krasniqi, anëtar kyç në formulimin e planit kriminal! Inkurajoi krimet ndaj kundërshtarëve - Shqiptarja.com |
| ADRESA | `https://shqiptarja.com/lajm/haga-smith-lexon-gjetjet-per-jakup-krasniqin-ja-cfare-provoi-gjykata` |
| BURIMI | shqiptarja.com |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 10:01:26 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 09:27:33 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `d7bc18ac5f02c77522eee3ef79772d2eec5dd60149cfc17298dd86c501203c50` |
| TEKSTI | `7b04eac5b3a362fac68afb0f561594435ba022908473312cf7c91d78f0126e9e` |
| PAMJA | `4483f959a9f54af0d0759d3d68fa33599cd7681a39439ab6b1f12e13b2b05b8b` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `f321b9840c6ab2776256a346b1256a28e4546ba4717157ae5d038dd08d6f9141` |
| E MËPARSHMJA | `87e4eeeb8e009ed2bdd773c518c59e15dc8bb27963109c85c373ef436d25b83e` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/f321b9840c6ab2776256a346b1256a28e4546ba4717157ae5d038dd08d6f9141`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





# Gjyqi ndaj UÇK/ Gjykata Speciale: Krasniqi, anëtar kyç në formulimin e planit kriminal! Inkurajoi krimet ndaj kundërshtarëve

[Sh] .com Redaksia
16 Shtator, 11:24 | **Përditesimi: 16 Shtator, 14:38**

Share Tweet




Gjykata në Hagë tha se Jakup Krasniqi ishte një nga personat që ndihmoi në hartimin dhe zbatimin e asaj që e cilëson qëllim të përbashkët kriminal.

Sipas gjykatësit Charles Smith, Krasniqi përdori rolin e tij si zëdhënës i UÇK-së për të promovuar politikën e shënjestrimit të kundërshtarëve, emëroi persona besnikë në pozita kyçe për zbatimin e saj dhe, megjithëse kishte dijeni për krimet që po kryheshin, nuk ndërmori hapa për t'i parandaluar ose ndëshkuar.

Gjykata tha gjithashtu se ai inkurajoi kryerjen e krimeve përmes komunikatave dhe deklaratave publike dhe se, së bashku me tre të akuzuarit e tjerë, ishte pjesë e ndërmarrjes së përbashkët kriminale.

[Sh] .com



LEXO EDHE:
**Preç Zogaj: Dënimet në Hagë, midis solidaritetit njerëzor ndaj të akuzuarve dhe keqkuptimeve alla shqiptare për drejtësinë**

> *"Krasniqi ishte anëtar kyç në formulimin e politikës së shënjestrimit të kundërshtarëve. Ai përdori rolin e tij si zëdhënës i UÇK-së për formulimin e kësaj politike. Përmes publikimit të komunikatave dhe fjalimeve publike, ai inkurajoi kryerjen e krimeve kundër kundërshtarëve, përfshirë përmes luftës speciale të UÇK-së. Ai përhapi dhe promovoi qëllimin e përbashkët kriminal. Emëroi persona besnikë në pozita kyçe dhe krijoi organe speciale me detyrën e zbatimit të politikës kundër kundërshtarëve. Në atë kohë kishte dijeni për një numër të konsiderueshëm krimesh të kryera kundër kundërshtarëve, por nuk ndërmori asnjë hap për parandalimin apo ndëshkimin e tyre. Ai i mohoi këto krime dhe e portretizoi UÇK-në si një organizatë që promovonte të drejtën ndërkombëtare. Trupi gjykues konstaton se të katër të akuzuarit kishin një qëllim të përbashkët kriminal dhe synuan kryerjen e krimeve për realizimin e këtij qëllimi. Për këtë arsye, të katërt mbajnë përgjegjësi penale në kuadër të ndërmarrjes së përbashkët kriminale", thotë gjyqtari.*

*Lajmi kryesor:*
**Ditë e zezë për Kosovën/ Haga dënon me 81 vite burg 4 ish-krerët e UÇK-së për krime lufte! Nga 25 vite për Thaçin e Krasniqin, rrëzohen akuzat për krime kundër njerëzimit (VIDEO)**

U.D/E.H/Shqiptarja.com

TAG: Jakup Krasniqi | Gjyqi ndaj UCK ne Hage

Sa e vlerësoni këtë artikull? ★★★★★ 5.0 / 5 (1 vlerësim)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:** 16 Shtator, 14:18

**Haga dënon me 81 vite burg 4 ish-krerët e UÇK-së, si e vlerësoni?**

Të drejtë | Të gabuar | Nuk e di

## Lajme të tjera



Protestuesit 5 net në shesh kundër vendimit të Hagës, 'skuqet' Prishtina! Shpaloset flamuri Kombëtar gjigant, kërkohet drejtësi për 4 ish-krerët e UÇK (VIDEO)

20 Shtator, 21:28



Dënimi me 81 vite burg i 4 ish-krerëve të UÇK, shqiptarët protestë edhe në Vjenë të Austrisë: O Hashim, ti ku je, krejt Kosovën këtu e ke! (VIDEO)

20 Shtator, 16:25



Njeriu i 17 shkurtit nën hijen e 16 shtatorit

20 Shtator, 15:11



Verdikti i Hagës ndaj krerëve të UÇK-së, Tedi Blushi kërkon interpelancë me Ramën: Çfarë hapash do ndërmarrë Qeveria për rrëzimin e aktgjykimit?

20 Shtator, 13:40



Në kërkim ndërkombëtar për trafik droge, arrestohet në Morinë 34-vjeçari nga Kosova (EMRI)

20 Shtator, 11:31



A ishte paralajmëruar dënimi i ish-krerëve të UÇK-së? Kryeprokurori i Speciales më 2020: Do burgosen përjetë

20 Shtator, 08:54



5 ditë pas vendimit të Hagës, Prishtina sërish në shesh: Na ka bashkuar UÇK-ja! Tubime edhe në Gjermani, Zvicër, Austri e Kanada (VIDEO)

20 Shtator, 07:15



Vendimi ndaj ish krerëve të UÇK-së, Kurti nga SHBA: Duhet strategji shtetërore dhe bashkëpunim me aleatët tanë ndërkombëtarë

19 Shtator, 22:52



Pas Hagës, kush do ta çojë përpara drejtësinë për krimet e luftës në Ballkan?

19 Shtator, 21:58



Dënimi i liderëve të UÇK, Prishtina sërish në protestë! Tubime në Gjermani e Austri

19 Shtator, 21:43



Pandeli Majko: Ku gabuam...?



Pandeli Majko

19 Shtator, 19:22



Adri Nurellari: Pas deklaratës së Kuvendit tek veprimi, çfarë duhet të bëjë Shqipëria për Kosovën



Adri Nurellari

19 Shtator, 18:58




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.